



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	05.03.2014
REFERENC-Ë:	AKK-DPK
PËR/ZA/TO:	z. Mentor Borovci, Drejtor i Departamentit Ligjor, në Ministrin e Diasporës
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Hasan Preteni, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me ofrimin e këshillimit profesional për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin të funksionit publik



I nderuar z. Borovci,

Në mbështetje të nenit 5 (paragrafi 1 nënparagrafi 1.12) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit dhe nenit 19 (paragrafi 1 nënparagrafi 1.5 dhe 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, lidhur me kërkesën tuaj, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

OPINION

Ushtrimi i funksionit Publik si Drejtor i Departamentit ligjor ne Ministrin e Diasporës dhe ushtrimi i funksionit publik të Anëtarit të Komisionit të Pavarur për Media, paraqet papajtueshmëri te funksioneve dhe kufizim krahas ushtrimit te funksionit publik.

ARSYETIM

Agjencia kundër Korrupsionit ka pranuar kërkesë nga z.Mentor Borovci, me numër të protokollit 03-03-716/14, me të cilën është kërkuar nga ne si autoritet kompetent për trajtimin e rasteve të

konfliktit të interesit, të shqyrtohet situata e mundshme e konfliktit të interesit si ushtrues i funksionit të Drejtorit të Departamentit Ligjor në Ministrinë e Diasporës dhe Aplikimit për Anëtar të Komisionit të Pavarur për Media.

Rrjedhimisht, çështja e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik është e rregulluar me Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (në tekstin e mëtejshëm Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit). Në bazë të këtij ligji pozita juaj si drejtor i departamentit hynë në kategorinë e zyrtarëve të lartë publik, pasi që shprehimisht është e përcaktuar në nenin 4 pika 1.13 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Në bazë të nenit 7.8 të Ligjit Nr. 04/L-051, Zyrtari i lartë nuk duhet të lejoj që interesat e tij private të bien në konflikt me funksionin e tij. Ai duhet të shmang konfliktin e interesit pavarësisht nëse ai është real, apo i mundshëm, ndërsa sipas neni 8 të këtij ligji, të gjithë zyrtarët e lartë kanë detyrë që të parandalojnë e konfliktit të interesit dhe të zgjidhin vetë brenda afatit ligjor, dhe në mënyrën më efektive të mundshme, çdo situatë të konfliktit të tyre të interesit.

Agjencia kundër Korrupsionit, si institucion me mandat që ka, ndër të tjera, bën këshillimin e zyrtarëve të lartë të veçantë, të eporeve, të institucioneve epore, me kërkesën e tyre, për raste të caktuara të shfaqjes së konfliktit të interesave (neni 19, pika 1.5).

Pas shqyrtimit me kujdes të kërkesës suaj, në pajtim me dispozitat në fuqi dhe mandatin e përcaktuar ligjor, duke i marrë parasysh të gjitha faktet dhe rrethanat relevante që i posedojmë në lidhje me gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit lidhur me këtë rast, Konstatojmë se :

Aplikimi juaj për pozitën e Anëtarit të Komisionit të Pavarur për Media nuk paraqet konflikt të interesit, mirëpo ushtrimi i këtyre dy funksioneve në të njëjtën kohë, si Drejtor i Departamentit Ligjor në Ministrinë e Diasporës dhe funksionit të Anëtarit të Komisionit të Pavarur për Media paraqet papajtueshmëri të funksioneve dhe kufizim krahas ushtrimit të funksionit publik, dhe shkakton gjendjen e konfliktit të interesit në ushtrim të funksionit publik, andaj nuk duhet vazhduar mbajtja e këtyre dy funksioneve pasi që bie ndesh me 16.1 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, ku ndër të tjera thotë (Zyrtari i lartë publik nuk mund të jetë menaxhues ose anëtar i organeve menaxhuese në organizata fitimprurëse dhe jo fitimprurëse, përjashtuar subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet për shkak të funksionit).

Ju rekomandojmë që të ndërmerrni të gjitha masat konform këtij opinioni, që të parandaloni këtë situatë që mund të ju sjell në gjendje të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, e për të cilën janë të paraparë sanksionet sipas ligjeve në fuqi.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin tuaj shpresojmë se ky opinion do të ju sqaron gjendjen e dyshuar për konflikt të interesit të ngritur nga ju, si dhe do të ju informoj për shmangien nga gjendja me elemente të Konfliktit të Interesit.

Me respekt!